

Broshurë teknike

ISOMAT AK-THERMO

Ngjitës me bazë çimentoje me performancë të lartë, i përforcuar me fibra, i modifikuar me polimer, për pllaka termoizoluese

Përshkrimi

ISOMAT AK-THERMO është një ngjitës me bazë çimentoje i përforcuar me fibra dhe i pasuruar me polimer (rrëshira). Ofron një forcë ngjitëse fillestare dhe përfundimtare të lartë, si dhe elasticitet dhe rezistencë ndaj lagështisë. Klasifikohet si absolutisht pa rrëshqitje dhe mund të përdoret edhe pasi është mbajtur hapur për kohë të gjatë. I certifikuar sipas EN 998-1 dhe i klasifikuar si llaç përpunimi GP CS IV W2. Gjithashtu i certifikuar sipas EN 12004 dhe i klasifikuar si ngjitës C2E. i shënuar si CE.

Fushat e përdorimit

ISOMAT AK-THERMO përdoret në kombinim me suvanë MARMOCRET-PLUS dhe MARMOCRYL si një system për aplikim në pllakat termoizoluese.

Përshatet për ngjitjen e pllakave termoizoluese të polistirenit mbi nënshtresa me bazë çimenton. Për më tepër, kur përforcohet me rrjetë me fibër xhami dhe aplikohet në pjesën e jashtme të pllakave të fiksuara të termoizolimit, përbën sipërfaqen ideale për shtresën e suvasë që do të hidhet më pas.

Të dhënat teknike

Trajta:	llaç çimentoje
Ngjyra:	e bardhë
Uji që nevojitet:	6,25 kg/thes 25 kg
Densiteti i volumit të llaçit të thatë:	1,40 ± 0,10 kg/l
Densiteti i volumit të llaçit të njomë:	1,55 ± 0,10 kg/l
Temperatura e përdorimit:	nga +5°C deri në +35°C
Koha e punueshmërisë:	të paktën 6 orë
Koha e mbajtjes hapur:	të paktën 20 minuta
Koha e mbajtjes hapur për riparime të vogla:	të paktën 20 minuta
Rezistenca në shtypje:	≥ 14,50 N/mm ²
Forca në përkulje:	≥ 5,00 N/mm ²

Ngjitja:

- Në beton: ≥ 2,00 N/mm²
- Në XPS: ≥ 0,25 N/mm²
- Në EPS: ≥ 0,10 N/mm²

Përthithja kapilare e ujit: ≤ 0,2 kg/m²min^{0,5}

Përcjellshmëria termike: (λ10, e thatë) 0,43 W/mK

Përshkueshmëria nga avujt e ujit: (μ): 20

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Sipërfaqja që do të mbulohet me pllaka duhet të jetë plotësisht e pastër dhe pa pluhur, graso, bojë, grimca të lira etj. Rekomandohet që ajo të njomet përpara se aplikimit të materialit.

2. Përdorimi

Si ngjitës:

ISOMAT AK-THERMO hidhet gradualisht në ujë duke u trazuar vazhdimisht, derisa të krijohet një masë homogjene në trajtë brumi. Për përzierjen rekomandohet përdorimi i një mikseri me xhiro të ulëta. Përzierja duhet të lihet rreth 10 minuta të pushojë dhe pastaj duhet të trazohet pak përsëri. Në nënshtresa të lëmuara ngjitësi përhapet mbi pllakën termoizoluese dhe krihet duke përdorur një mallë të dhëmbëzuar (krehër), me qëllim që të aplikohet në mënyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen.

Në nënshtresat e paniveluara ngjitësi përhapet me një mallë rreth perimetrit të pllakës së termoizolimit dhe në pikat e përzgjedhura në qendër.

Pas kësaj, pllakat e termoizolimit fiksohen duke u ngjeshur në pozicionin e dëshiruar.

Si llaç i përforcuar:

Fillimisht materiali hapet me një mallë të dhëmbëzuar në një trashësi maksimale prej 3 mm. Në shtresën ende të njomë vendoset rrjeta prej fibrës së xhamit duke u ngjeshur me një mallë të lëmuar që të njësohet plotësisht me kolën. Në fund, sipërfaqja fërkohet dhe hiqet ngjitësi i tepërt.

ISOMAT AK-THERMO

Konsumi

Si ngjitës: 2,0-4,0 kg/m², në varësi të madhësisë së dhëmbëve të mallës dhe të natyrës së nënshtrësës.

Si llaç i përforcuar: rreth 1,5 kg/m²/mm.

Ambalazhimi

ISOMAT AK-THERMO ofrohet në thasë letre 25 kg.

Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim, në thasë të izoluar dhe në ambiente të thata, është minimumi 12 muaj.

Shënime

- ISOMAT AK-THERMO përmban çimento dhe reagon si alkaline me ujin, kështu që klasifikohet si irritues.
- Sipërfaqet shumë poroze, si p.sh betoni i lehtë, pllakat e gipsit, pllakat e zdrukthit etj. duhet të lyhen fillimisht me astarin akrilik UNI-PRIMER.
- Shikoni rreziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.



ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

11

EN 12004:2007+A1:2012

DoP No.: ISOMAT AK-THERMO/1067-02
NB: 2032

Improved cementitious adhesive with extended open time, for internal and external tiling.

Bond strength, as:

- initial tensile adhesion strength

≥ 1 N/mm²



ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

11

EN 998-1

General purpose rendering mortar (GP)
for external use

DoP. No.: ISOMAT AK-THERMO/1240-04

Reaction to fire: Class A1

Adhesion: 2,0 N/mm² – FP: A

Water absorption: W2

Water vapour diffusion coeff.: μ 20

Thermal conductivity: (λ_{10,dy}) 0,43 W/mK

Durability (against freeze/thaw): evaluation based on provisions valid in the intended place of use of the mortar

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS, MORTARS & PAINTS
SELIA NË SELANIK, GREQI

Kilometri i 17të i Autostradës Selanik - Aj. Athanasiu 570 03
T +30 2310 576 002

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu